

02 Kryetari i Komunës
Nr. 221/01-15253/23
Dt: 07.07.2023
Dragash

Kryetari i Komunës, në baz të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 02-221/01-15253/23 të dates 07.07.2023, të parashtruar nga Zeni Krasniqi – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, për shfrytëzimin e hapsirave, oborret e shkollave si parkingje për bashkatdhetarët, nxjerr këtë:

V E N D I M

- 1. APROVOHET:** kërkesa nr . 02-221/01-15253/23 e dates 07.07.2023, e parashtruar nga Zeni Krasniqi – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, për shfrytëzimin e hapësirave, oborret e shkollave **si parkingje për Bashkatdhetarët pa pages.**
- 2.** Obligohen Drejtorët e shkollave të cilat kanë hapsira të mjaftueshme në shkolla, ti lejojnë për shfrytëzim për parkingje në muajt e verës e atë nga data 15.07.2023 e deri me datën 20.08.2023.
- 3.** Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Drejtorët e shkollave.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë Komunale për Arsim
- Drejtorëve të shkollave dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

